



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 82

Tiranë – E hënë, 20 prill 2026

PËRMBAJTJA

| | Faqe | |
|---|--|------|
| Ligj nr. 33/2026, datë 2.4.2026 | Për ratifikimin e vendimit nr. 1/2025 të Komitetit të Përbashkët, i krijuar nga marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, duke zëvendësuar protokollin ii të saj, në lidhje me përcaktimin e konceptit të “Produkteve Origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ..... | 7311 |
| Dekret i Presidentit nr. 250, datë 16.4.2026 | Për shpallje ligji..... | 7317 |
| Ligj nr. 34/2026, datë 2.4.2026 | Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin e Najrobit për mbrojtjen e simbolit olimpike, bërë në Najrobi, më 26 shtator 1981..... | 7317 |
| Dekret i Presidentit nr. 229, datë 15.4.2026 | Për shpallje ligji..... | 7323 |
| Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 1, datë 15.4.2026 | Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrit elektronik të ekspertëve..... | 7323 |
| Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë /Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 10, datë 17.4.2026 | Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit..... | 7326 |
| Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë /Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 11, datë 18.4.2026 | Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit..... | 7327 |



LIGJ
Nr. 33/2026

PËR RATIFIKIMIN E VENDIMIT NR. 1/2025 TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT, I KRIJUAR NGA MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË TURQISË, DUKE ZËVENDËSUAR PROTOKOLLIN II TË SAJ, NË LIDHJE ME PËRCAKTIMIN E KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE ORIGJINUESE” DHE METODAVE TË BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet vendimi nr. 1/2025 i Komitetit të Përbashkët, i krijuar nga marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, duke zëvendësuar protokollin II të saj, në lidhje me përcaktimin e konceptit të “Produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

Miratuar në datën 2.4.2026.

Shpallur me dekretin nr. 250, datë 16.4.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

VENDIM NR. 1/2025

I KOMITETIT TË PËRBASHKËT,
I KRIJUAR NGA MARRËVESHJA E
TREGTISË SË LIRË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
REPUBLIKËS SË TURQISË
PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË TURQISË,
DUKE ZËVENDËSUAR PROTOKOLLIN
II TË SAJ, NË LIDHJE ME PËRCAKTIMIN E
KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE
ORIGJINUESE” DHE METODAVE TË
BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Komiteti i Përbashkët,

duke pasur parasysh Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë (në vijim e referuar si: “Marrëveshja”), dhe në veçanti nenin 37 të Protokollit II të saj, lidhur me përcaktimin e konceptit të “Produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ;

duke pasur parasysh se:

1. Neni 22 i Marrëveshjes i referohet Protokollit II të asaj Marrëveshjeje (Protokolli II), i cili përcakton rregullat e origjinës,

2. Neni 37 i Protokollit II parashikon që Komiteti i Përbashkët i krijuar nga neni 28 i Marrëveshjes mund të vendosë të ndryshojë dispozitat e Protokollit II,

3. Konventa Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Mediterrane¹ (Konventa) synon të transpoztojë sistemet ekzistuese dypalëshe të rregullave të origjinës, të vendosura në marrëveshjet dypalëshe të tregtisë së lirë, të lidhura ndërmjet palëve kontraktuese të Konventës në një kuadër shumëpalësh, pa cenuar parimet e përcaktuara në ato marrëveshje dypalëshe,

4. Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë nënshkruan Konventën përkatësisht më 27.6.2011 dhe 4.11.2011,

5. Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë depozituan dokumentet e tyre ligjore të pranimit tek depozitari i Konventës përkatësisht më 5.3.2012 dhe 4.12.2013. Si rrjedhojë, në përputhje me nenin 10(3) të Konventës, Konventa ka hyrë në fuqi, në lidhje me Republikën e Shqipërisë dhe

¹ OJ EU L 54, 26.2.2013, f. 4.



Republikën e Turqisë, përkatësisht më 1.5.2012 dhe 1.2.2014,

6. Protokollu II u zëvendësua nga një Protokoll i ri që i referohet Konventës, me vendimin nr. 1/2020, të Komitetit të Përbashkët të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë,

7. Konventa është ndryshuar me vendimin nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Mediterrane, datë 7 dhjetor 2023²,

8. Si rrjedhojë, Protokollu II duhet të zëvendësohet nga një Protokoll i ri për të përfshirë një referencë dinamike ndaj Konventës, në mënyrë që t'i referohet gjithmonë versionit më të fundit të Konventës në fuqi;

ka miratuar këtë vendim:

Neni 1

Protokollu II i Marrëveshjes, në lidhje me përcaktimin e konceptit të “Produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, zëvendësohet me tekstin e përcaktuar në shtojcën e këtij vendimi.

Neni 2

Ky vendim do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 34 të Marrëveshjes.

Ky vendim do të zbatohet nga data 1.1.2025.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar të mëposhtëm, kanë nënshkruar sipas rregullave këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 24 dhjetor 2025, në dy kopje autentike, në gjuhët shqipe, turke dhe angleze, të gjitha tekstet janë njësoj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti anglisht do të mbizotërojë.

Për Republikën e Shqipërisë

Enkelejd Musabelliu

ZËVENDËSMINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

Për Republikën e Turqisë

Tayyar Kağan Atay

AMBASADOR I REPUBLIKËS SË
TURQISË NË TIRANË

SHTOJCA

“PROTOKOLLI II

NË LIDHJE ME PËRCAKTIMIN E KONCEPTIT TË “PRODUKTEVE ORIGJINUESE” DHE METODAVE TË BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Neni 1

Rregullat e origjinës

1. Për qëllimin e zbatimit të Marrëveshjes, shtojca I dhe dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës Rajonale për rregullat e origjinës preferenciale Pan-Euro-Mediterrane³ (Konventa), do të zbatohen, siç janë ndryshuar dhe botuar së fundi në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

2. Të gjitha referencat për “Marrëveshjen përkatëse” në shtojcën I dhe në dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës do të interpretohen në mënyrë që të nënkuptojnë Marrëveshjen.

Neni 2

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kur lindin mosmarrëveshje në lidhje me procedurat e verifikimit të përcaktuara në nenet 34 dhe 35, të shtojcës I të Konventës, të cilat nuk mund të zgjidhen ndërmjet autoriteteve doganore që kërkojnë verifikimin dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ato duhet t'i paraqiten Komitetit të Përbashkët.

2. Në të gjitha rastet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues do të bëhet sipas legjislacionit të atij vendi.

Neni 3

Ndryshimi i Protokollit

Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë dispozitat e këtij Protokollit.

Neni 4

Tërheqja nga Konventa

Nëse Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë njoftojnë me shkrim depozitarin e Konventës për qëllimin e tyre për t'u tërhequr nga

² OJ EU L, 2024/390, 19.2.2024

³ OJ EU L 54, 26.2.2013, f. 4.



Konventa, sipas nenit 9 të saj, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë do të hyjnë menjëherë në negociata për rregullat e origjinës, me qëllim zbatimin e Marrëveshjes.

Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave të origjinës, të saponegociuara, rregullat e origjinës të përfshira në shtojcën I dhe, sipas rastit, dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës, të zbatueshme

në momentin e tërheqjes, do të vazhdojnë të zbatohen për Marrëveshjen. Megjithatë, që nga momenti i tërheqjes, rregullat e origjinës të përfshira në shtojcën I dhe, sipas rastit, dispozitat përkatëse të shtojcës II të Konventës do të interpretohen në mënyrë që të lejojnë kumulimin dypalësh vetëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.”.

DECISION NO 1/2025 of the JOINT COMMITTEE
established by the Free Trade Agreement Between the Republic of Albania and
the Republic of Türkiye
amending the Agreement
between the Republic of Albania and the Republic of Türkiye,
by replacing Protocol II thereto concerning the definition
of the concept of "originating products" and methods of administrative
cooperation

The Joint Committee,

Having regard to the Free Trade Agreement between the Republic of Albania and the Republic of Türkiye (hereinafter: “the Agreement”), and in particular Article 37 of Protocol II thereto concerning the definition of the concept of "originating products" and methods of administrative cooperation,

Whereas:

- (1) Article 22 of the Agreement, refers to Protocol II to that Agreement ("Protocol II"), which lays down the rules of origin.
- (2) Article 37 of Protocol II provides that the Joint Committee established by Article 28 of the Agreement may decide to amend the provisions of Protocol II.
- (3) The Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin¹ ('the Convention') aims to transpose the existing bilateral systems of rules of origin established in bilateral free trade agreements concluded among the Contracting Parties to the Convention into a multilateral framework, without prejudice to the principles laid down in those bilateral agreements.
- (4) The Republic of Albania and the Republic of Türkiye signed the Convention on 27/06/2011 and 04/11/2011 respectively.

¹ OJ EU L 54, 26.2.2013, p. 4.



- (5) The Republic of Albania and the Republic of Türkiye deposited their instruments of acceptance with the depositary of the Convention on 05/03/2012 and 04/12/2013 respectively. Consequently, in accordance with Article 10(3) of the Convention, the Convention entered into force in relation to The Republic of Albania and the Republic of Türkiye on 01/05/2012 and 01/02/2014 respectively.
- (6) Protocol II was replaced by a new protocol making reference to the Convention, by Decision No 1/2020 of the Republic of Albania and the Republic of Türkiye Joint Committee.
- (7) The Convention was amended by Decision No 1/2023 of the Joint Committee of the Regional Convention on Pan-Euro-Mediterranean Preferential Rules of Origin of 7 December 2023².
- (8) Protocol II should therefore be replaced by a new protocol to include a dynamic reference to the Convention, so as to refer always to the latest version of the Convention in force,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Protocol II to the Agreement, concerning the definition of the concept of "originating products" and methods of administrative cooperation is replaced by the text set out in the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force in accordance with Article 34 of the Agreement.

This Decision shall apply as from 1/1/2025.

² OJ EU L, 2024/390, 19.02.2024



IN WITNESS WHEREOF the undersigned plenipotentiaries, being duly authorised thereto, have signed this Agreement.

Done in Tirana on 24 December 2025 in two authentic copies in Albanian, Turkish and English languages, all texts being equally authentic. In case of any divergence in the interpretation of this Agreement, the English text shall prevail.

For the Republic of Albania

Enkelejd Musabelliu
Deputy Minister of Economy and
Innovation

A blue ink signature of Enkelejd Musabelliu, consisting of a long horizontal stroke with a vertical line crossing it near the right end.

For the Republic of Türkiye

Tayyar Kağan Atay
Ambassador of the Republic of Türkiye
in Tirana

A blue ink signature of Tayyar Kağan Atay, featuring a large, stylized circular loop on the left side and a horizontal line extending to the right.

**ANNEX****"Protocol II
concerning the definition of the concept of 'originating products'
and methods of administrative cooperation***Article 1****Rules of origin***

1. For the purpose of implementing the Agreement, Appendix I and the relevant provisions of Appendix II to the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin¹ ("the Convention"), as last amended and published in the *Official Journal of the European Union*, shall apply.
2. All references to the "relevant agreement" in Appendix I and in the relevant provisions of Appendix II to the Convention shall be construed so as to mean the Agreement.

*Article 2****Dispute settlement***

1. Where disputes arise in relation to the verification procedures set out in Articles 34 and 35 of Appendix I to the Convention that cannot be settled between the customs authorities requesting the verification and the customs authorities responsible for carrying out that verification, they shall be submitted to the Joint Committee.
2. In all cases, the settlement of disputes between the importer and the customs authorities of the importing country shall take place under the legislation of that country.

*Article 3****Amendments to the Protocol***

The Joint Committee may decide to amend the provisions of this Protocol.

¹ OJ EU L 54, 26.2.2013, p. 4.

*Article 4****Withdrawal from the Convention***

1. Should either the Republic of Albania and the Republic of Türkiye give notice in writing to the depositary of the Convention of their intention to withdraw from the Convention according to Article 9 thereof, the Republic of Albania and the Republic of Türkiye shall immediately enter into negotiations on rules of origin for the purpose of implementing the Agreement.
2. Until the entry into force of such newly negotiated rules of origin, the rules of origin contained in Appendix I and, where appropriate, the relevant provisions of Appendix II to the Convention, applicable at the moment of withdrawal, shall continue to apply to the Agreement. However, from the moment of withdrawal, the rules of origin contained in Appendix I and, where appropriate, the relevant provisions of Appendix II to the Convention shall be construed so as to allow bilateral cumulation only between the Republic of Albania and the Republic of Türkiye."

DEKRET

Nr. 250, datë 16.4.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 33/2026, "Për ratifikimin e vendimit nr. 1/2025 të Komitetit të Përbashkët, i krijuar nga marrëveshja e tregtisë së lirë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, duke zëvendësuar protokollin II të saj, në lidhje me përcaktimin e konceptit të 'Produkteve origjinuese' dhe metodave të bashkëpunimit administrativ".

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 34/2026

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN
E NAJROBIT PËR MBROJTJEN
E SIMBOLIT OLIMPIK, BËRË
NË NAJROBI, MË 26 SHTATOR 1981**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Traktatin e Najrobot për Mbrojtjen e Simbolit Olimpik, bërë në Najrobi, më 26 shtator 1981, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.4.2026.

Shpallur me dekretin nr. 229, datë 15.4.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**TRAKTATI I NAJROBIT
PËR MBROJTJEN E SIMBOLIT OLIMPIK**

Miraturar në Najrobi, më 26 shtator 1981

Tabela e përmbajtjes*

Kapitulli I: Dispozitat themelore

Artikulli 1: Detyrimet e shtetit

Artikulli 2: Përjashtimet nga detyrimi

Artikulli 3: Pezullimi i detyrimit

Kapitulli II: Grupimet e shteteve

Artikulli 4: Përjashtimet nga kapitulli I

Kapitulli III: Klauzolat përfundimtare

Artikulli 5: Pjesëmarrja në Traktat

Artikulli 6: Hyrja në fuqi e Traktatit

Artikulli 7: Denoncimi i Traktatit

Artikulli 8: Nënshkrimi dhe gjuhët e Traktatit

Artikulli 9: Depozitimi i Traktatit; transmetimi

i kopjeve, regjistrimi i marrëveshjes

Artikulli 10: Njoftimet

Aneksi

**KAPITULLI I
DISPOZITAT THEMELORE**

Neni 1

Detyrimi i shteteve

Çdo shtet palë në këtë Traktat ka detyrimin t'u nënshtrohet neneve 2 dhe 3, të refuzojë ose të zhvlerësojë regjistrimin si markë dhe të ndalojë me masat e duhura përdorimin, si markë ose shenjë, për qëllime tregtare, të çdo shenjë që përbëhet ose përmban Simbolin Olimpik, siç përcaktohet në Kartën e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, përveçse me autorizimin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Përkufizimi i përmendur dhe paraqitja grafike e simbolit në fjalë janë rivendosur dhe përcaktuar në shtojcë.

Faqe | 7318

* Kjo tabelë e përmbajtjes është shtuar për lehtësinë e lexuesit. Ajo nuk shfaqet në tekstin e firmosur të Traktatit.

Neni 2

Përjashtimet nga detyrimi

1. Detyrimi i parashikuar në nenin 1, nuk detyron asnjë shtet palë në këtë Traktat, në lidhje me:

i. Çdo markë që përbëhet nga ose përmban Simbolin Olimpik ku ajo markë është regjistruar në atë shtet përpara datës në të cilën ky Traktat hyn në fuqi, në lidhje me atë shtet ose gjatë çdo periudhe gjatë së cilës, në atë shtet, detyrimi i parashikuar në nenin 1 konsiderohet i pezulluar sipas nenit 3.

ii. përdorimin e vazhdueshëm për qëllime tregtare të ndonjë marke ose shenje tjetër, që përbëhet nga ose përmban Simbolin Olimpik, në atë shtet nga çdo individ ose kompani i/e cili ka filluar ligjërisht një përdorim (të simbolit olimpik) në shtetin në fjalë përpara datës në të cilën ky Traktat hyn në fuqi në lidhje me atë shtet ose gjatë çdo periudhe gjatë së cilës, në atë shtet, detyrimi i parashikuar në nenin 1 konsiderohet i pezulluar sipas nenit 3.

2. Dispozitat e paragrafit 1(i) do të zbatohen, gjithashtu, në lidhje me markat, regjistrimi i të cilave ka ndikim në atë shtet, në bazë të një regjistrimit, sipas Traktatit në të cilin shteti në fjalë është palë.

3. Përdorimi i autorizimit nga një individ ose kompanie e përmendur në paragrafin 1(ii) duhet të merret në konsideratë, për qëllimet e paragrafit të lartpërmendur, si përdorim nga individit ose kompania.

4. Asnjë shtet palë në këtë Traktat nuk do të jetë i detyruar të ndalojë përdorimin e Simbolit Olimpik, kur ai simbol përdoret si formë e një informimit masiv për qëllime informuese të lëvizjen olimpike ose aktivitetet e saj.

Neni 3

Pezullimi i detyrimit

Detyrimi i parashikuar në nenin 1 mund të konsiderohet si i pezulluar nga çdo shtet, palë në këtë Traktat gjatë çdo periudhe përgjatë së cilës nuk ka marrëveshje në fuqi ndërmjet Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe nga Komitetit Olimpik Kombëtar me shtetin në fjalë, në lidhje



me kushtet në të cilat Komiteti Olimpik Ndërkombëtar do të japë autorizime për përdorimin e Simbolit Olimpik në atë shtet dhe për sa i përket pjesës së të ardhurave, që Komiteti Olimpik Ndërkombëtar përfiton për dhënien e autorizimeve të përmendura.

KAPITULLI II GRUPIMET E SHTETEVE

Neni 4 Përjashtimet nga kapitulli I

Dispozitat e kapitullit I, në lidhje me shtetet palë në këtë Traktat, të cilat janë anëtarë të bashkimit doganor, një zonë e tregtisë së lirë, çdo grupimi tjetër ekonomik ose e ndonjë grupi tjetër rajonal, ose nënrajonal, do të jenë të pacenuara ndaj angazhimeve të tyre sipas instrumentit që e krijon një bashkim të tillë zonë ose grupim tjetër, veçanërisht në lidhje me dispozitat e këtij instrumenti, i cili rregullon lëvizjen e lirë të mallrave ose shërbimeve.

KAPITULLI III KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 5 Pjesëmarrja në Traktat

Çdo shtet anëtar i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (i referuar me poshtë si “Organizata”) ose e Unionit Ndërkombëtar (të Paris) për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (i referuar në kontrate si “Unioni i Parisit”) mund të bëhet palë e këtij Traktati, duke:

i. u nënshkruar e ndjekur nga depozitimi i një instrumenti ratifikimi, pranimit ose miratimit; dhe

ii. depozitimi i instrumentit të pranimit.

2. Çdo shtet që nuk përmendet në paragrafin 1, i cili është anëtar i Kombeve të Bashkuara ose ndonjë prej agjencive të specializuara i/e cila vihet në kontakt me Kombet e Bashkuara, mund të bëhet palë/pjesë e këtij Traktati duke depozituar një instrument aderimi.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit do të depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës (i referuar si “Drejtori i Përgjithshëm”)

Neni 6

Hyrja në fuqi e Traktatit

1. Në lidhje me tri shtetet që janë të parët që depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ky Traktat do të hyjë në fuqi një muaj pas ditës në të cilën instrumenti i tretë i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të jetë depozituar.

2. Në lidhje me çdo shtet tjetër, i cili depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ky Traktat do të hyjë në fuqi një muaj pas ditës në të cilën ai instrument është depozituar.

Neni 7

Denoncimi Traktatit

1. Çdo shtet mund të denoncojë këtë Traktat me anë të një njoftimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Denoncimi i Traktatit do të hyjë në fuqi, një vit pas ditës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftimin.

Neni 8

Nënshkrimi dhe gjuhët e marrëveshjes

1. Ky Traktat do të nënshkruhet në një origjinal të vetëm, në gjuhët angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, të gjitha tekstet janë në mënyrë të barabartë autentike.

2. Tekstet zyrtare do të vendosen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhët arabe, gjermane, italiane dhe portugeze dhe gjuhë të tjera që mund t'i përcaktojë Konferenca e Organizatës ose Asambleja e Unionit të Parisit.

3. Ky Traktat do të qëndrojë i hapur për nënshkrim në Najrobi deri më 31 dhjetor 1982 dhe më pas në Gjenevë deri më 30 qershor 1983.

Neni 9

Depozitimi i Traktatit; transmetimi i kopjeve; regjistrimi i Traktatit

1. Origjinali i këtij Traktati, kur nuk është më i hapur për nënshkrim në Najrobi, do të depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm.

2. Drejtori i Përgjithshëm do të dorëzojë dy kopje, të vërtetuara prej tij për origjinalitetin e këtij



Traktati të të gjitha shtetet e përmendura në nenin 5, pikat 1 dhe 2 dhe, sipas kërkesës, çdo shteti tjetër.

3. Drejtori i Përgjithshëm do ta regjistrojë këtë Traktat, në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara.

Neni 10 Njoftimet

Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë shtetet e përmendura në nenin 5, pikat 1 dhe 2, për:

- i. nënshkrimet sipas nenit 8;
- ii. depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit, ose aderimit, sipas nenit 5(3);
- iii. data e hyrjes në fuqi të këtij Traktati, sipas nenit 6(1);
- iv. çdo denoncim të njoftuar, sipas nenit 7.

ANEKSI

Simboli Olimpik përbëhet nga pesë unaza të ndërthurura: blu, e verdhë, e zezë, jeshile dhe e kuqe, të renditura nga e majta në të djathtë. Ai përbëhet vetëm nga unazat olimpike, qofshin të përcaktuara në një ngjyrë të vetme ose me ngjyra të ndryshme.

Nairobi Treaty on the Protection of the Olympic Symbol

adopted at Nairobi on September 26, 1981

TABLE OF CONTENTS*

| | |
|--------------|--|
| Chapter I: | Substantive Provisions |
| Article 1: | Obligation of States |
| Article 2: | Exceptions to the Obligation |
| Article 3: | Suspension of the Obligation |
| Chapter II: | Groupings of States |
| Article 4: | Exceptions to Chapter I |
| Chapter III: | Final Clauses |
| Article 5: | Becoming Party to the Treaty |
| Article 6: | Entry Into Force of the Treaty |
| Article 7: | Denunciation of the Treaty |
| Article 8: | Signature and Languages of the Treaty |
| Article 9: | Deposit of the Treaty; Transmittal of Copies; Registration of the Treaty |
| Article 10: | Notifications |
| | Annex |

CHAPTER I Substantive Provisions

Article 1: Obligation of States

Any State party to this Treaty shall be obliged, subject to Articles 2 and 3, to refuse or to invalidate the registration as a mark and to prohibit by appropriate measures the use, as a mark or other sign, for commercial purposes, of any sign consisting of or containing the Olympic symbol, as defined in the Charter of the International Olympic Committee, except with the authorization of the International Olympic Committee. The said definition and the graphic representation of the said symbol are reproduced in the Annex.

Article 2: Exceptions to the Obligation

- (1) The obligation provided for in Article 1 shall not bind any State party to this Treaty in respect of:
 - (i) any mark consisting of or containing the Olympic symbol where that mark was registered in that State prior to the date on which this Treaty enters into force in respect of that State or during any period during which, in that State, the obligation provided for in Article 1 is considered as suspended under Article 3;
 - (ii) the continued use for commercial purposes of any mark or other sign, consisting of or containing the Olympic symbol, in that State by any person or enterprise who or which has lawfully started such use in the said State prior to the date on which this Treaty enters into force in respect of that State or during any period during which, in that State, the obligation provided for in Article 1 is considered as suspended under Article 3.
- (2) The provisions of paragraph (1)(i) shall apply also in respect of marks whose registration has effect in the State by virtue of a registration under a treaty which the said State is a party to.

* This Table of Contents is added for the convenience of the reader. It does not appear in the signed text of the Treaty.



(3) Use with the authorization of the person or enterprise referred to in paragraph (1)(ii) shall be considered, for the purposes of the said paragraph, as use by the said person or enterprise.

(4) No State party to this Treaty shall be obliged to prohibit the use of the Olympic symbol where that symbol is used in the mass media for the purposes of information on the Olympic movement or its activities.

Article 3: Suspension of the Obligation

The obligation provided for in Article 1 may be considered as suspended by any State party to this Treaty during any period during which there is no agreement in force between the International Olympic Committee and the National Olympic Committee of the said State concerning the conditions under which the International Olympic Committee will grant authorizations for the use of the Olympic symbol in that State and concerning the part of the said National Olympic Committee in any revenue that the International Olympic Committee obtains for granting the said authorizations.

CHAPTER II Groupings of States

Article 4: Exceptions to Chapter I

The provisions of Chapter I shall, as regards States party to this Treaty which are members of a customs union, a free trade area, any other economic grouping or any other regional or subregional grouping, be without prejudice to their commitments under the instrument establishing such union, area or other grouping, in particular as regards the provisions of such instrument governing the free movement of goods or services.

CHAPTER III Final Clauses

Article 5: Becoming Party to the Treaty

(1) Any State member of the World Intellectual Property Organization (hereinafter referred to as “the Organization”) or of the International (Paris) Union for the Protection of Industrial Property (hereinafter referred to as “the Paris Union”) may become party to this Treaty by:

- (i) signature followed by the deposit of an instrument of ratification, acceptance or approval, or
- (ii) deposit of an instrument of accession.

(2) Any State not referred to in paragraph (1) which is a member of the United Nations or any of the Specialized Agencies brought into relationship with the United Nations may become party to this Treaty by deposit of an instrument of accession.

(3) instruments of ratification, acceptance, approval and accession shall be deposited with the Director General of the Organization (hereinafter referred to as “the Director General”).

Article 6: Entry Into Force of the Treaty

(1) With respect to the three States which are the first to deposit their instruments of ratification, acceptance, approval or accession, this Treaty shall enter into force one month after the day on which the third instrument of ratification, acceptance, approval or accession has been deposited.

(2) With respect to any other State which deposits its instrument of ratification, acceptance, approval or accession, this Treaty shall enter into force one month after the day on which that instrument has been deposited.



Article 7: Denunciation of the Treaty

- (1) Any State may denounce this Treaty by notification addressed to the Director General.
- (2) Denunciation shall take effect one year after the day on which the Director General has received the notification.

Article 8: Signature and Languages of the Treaty

- (1) This Treaty shall be signed in a single original in the English, French, Russian and Spanish languages, all texts being equally authentic.
- (2) Official texts shall be established by the Director General, after consultation with the interested Governments, in the Arabic, German, Italian and Portuguese languages, and such other languages as the Conference of the Organization or the Assembly of the Paris Union may designate.
- (3) This Treaty shall remain open for signature at Nairobi until December 31, 1982, and thereafter at Geneva until June 30, 1983.

Article 9: Deposit of the Treaty; Transmittal of Copies; Registration of the Treaty

- (1) The original of this Treaty, when no longer open for signature at Nairobi, shall be deposited with the Director General.
- (2) The Director General shall transmit two copies, certified by him, of this Treaty to all the States referred to in Article 5(1) and (2) and, on request, to any other State.
- (3) The Director General shall register this Treaty with the Secretariat of the United Nations.

Article 10: Notifications

The Director General shall notify the States referred to in Article 5(1) and (2) of:

- (i) signatures under Article 8;
- (ii) deposits of instruments of ratification, acceptance, approval or accession under Article 5(3);
- (iii) the date of the entry into force of this Treaty under Article 6(1);
- (iv) any denunciation notified under Article 7.

Annex

The Olympic symbol consists of five interlaced rings: blue, yellow, black, green and red, arranged in that order from left to right. It consists of the Olympic rings alone, whether delineated in a single color or in different colors.



DEKRET
Nr. 229, datë 15.4.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 34/2026, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Najrobi për Mbrojtjen e Simbolit Olimpik”, bërë në Najrobi, më 26 shtator 1981.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 1, datë 15.4.2026

**PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE
VËNIEN NË DISPOZICION PËR
PUBLIKUN TË REGJISTRIT
ELEKTRONIK TË EKSPERTËVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 224/a, paragrafi i dytë, dhe 224/d, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Pranë Ministrisë së Drejtësisë krijohet, administrohet dhe vihet në dispozicion për publikun Regjistri Elektronik i Ekspertëve.

2. Regjistri Elektronik i Ekspertëve mbahet në formë elektronike dhe organizohet në seksione, duke grupuar ekspertët sipas fushës së ekspertizës dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit, në përputhje me juridiksionin territorial të rretheve gjyqësore.

3. Regjistri Elektronik i Ekspertëve përmban këto të dhëna:

I. numrin rendor;

II. numrin e protokollit dhe datën e regjistrimit;

III. gjeneralitetet e ekspertit: emri, atësia, mbiemri;

IV. adresën e ushtrimit të aktivitetit profesional: numri, rrua dhe qyteti;

V. numrat e kontaktit: numri i telefonit kryesor dhe dytësor;

VI. adresën e postës elektronike;

VII. fushën e ekspertizës;

VIII. numrin e licencës;

IX. datën e lëshimit të licencës;

X. datën e përfundimit të vlefshmërisë së licencës;

XI. autoritetin që ka lëshuar licencën;

XII. Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS);

XIII. vitet e përvojës profesionale;

XIV. vitet e përvojës si ekspert në gjykatë;

XV. gjykatat për të cilat eksperti është i disponueshëm;

XVI. shënime/komente, përfshirë të dhëna të nevojshme që lidhen me aplikimin;

XVII. datën e miratimit fillestar në regjistrë;

XVIII. datën e rishikimit të ardhshëm;

XIX. statusin e regjistrimit, përfshirë fazën e shqyrtimit të aplikimit ose ushtrimit të ekspertizës.

4. Në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve regjistrohen ekspertët për të cilët legjislacioni në fuqi parashikon licencimin.

5. Në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve regjistrohen ekspertët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. të kenë zotësi të plotë për të vepruar;

ii. të kenë jo më pak se dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën përkatëse ose të ngjashme, ose pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji, nëse aplikanti ka përfunduar trajnim profesional në fushën përkatëse;

iii. të jenë të regjistruar dhe të kenë përmbushur rregullisht detyrimet në organet tatimore;

iv. të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

a) për një vepër penale të kryer me dashje/nga pakujdesia, për të cilën nuk janë rehabilituar;

b) për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën janë rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të ekspertit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi që normon ushtrimin e profesionit përkatës;



v. të jenë të pajisur me licencën profesionale përkatëse, sipas fushës së ekspertizës për të cilën paraqesin kërkesë për regjistrim.

6. Regjistri Elektronik i Ekspertëve publikohet në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Regjistri Elektronik i Ekspertëve plotësohet dhe përditësohet me të dhëna, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

II. Kërkesa për regjistrim

8. Kërkesa për regjistrim në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve paraqitet nëpërmjet portalit *e-Albania* në shërbimin “aplikim për ekspert gjykatë”.

III. Procedura e aplikimit

9. Aplikantët e interesuar për regjistrimin në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve plotësojnë formularin e aplikimit *online* në portalin *e-Albania*, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. jetëshkrimin;
- ii. licencën profesionale për fushën përkatëse;
- iii. vërtetimet e licencimit dhe kualifikimit;
- iv. vërtetime pune për përvojën profesionale;
- v. trajnime profesionale në fushën përkatëse;
- vi. vërtetim nga organet tatimore për përmbushjen e detyrimeve;
- vii. librezën e punës dhe dokumentacionin që provon pagesën e kontributeve shoqërore.

10. Në llogaritjen e përvojës profesionale merret në konsideratë e gjithë periudha e ushtrimit të saj, edhe nëse është ushtruar me ndërprerje.

11. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose të njësuara me origjinalin dhe paraqiten nëpërmjet portalit *e-Albania*.

12. Për çdo aplikim të ardhur në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve krijohet një dosje elektronike, në të cilën ruhen kërkesa e aplikimit, dokumentacioni shoqëruar dhe kartela e regjistrimit.

13. Ministria e Drejtësisë njofton aplikuesin për konfirmimin e marrjes së kërkesës së tij për regjistrim, në adresën elektronike të deklaruar në formularin e aplikimit *online*.

IV. Procedura e vlerësimit të aplikimit

14. Aplikimi dhe dokumentacioni shoqëruar, të paraqitura në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit *e-Albania*, shqyrtohen sipas radhës së regjistrimit. Aplikimi shqyrtohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim.

15. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për regjistrim, struktura përgjegjëse kryen procedurat e mëposhtme:

a) në rast se aplikanti nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë, sipas pikës 9 të këtij udhëzimi, kërkon plotësimin e tij brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit;

b) kërkon informacion shtesë dhe verifikim të të dhënave nga institucioni që ka licencuar ekspertin.

Në të dyja rastet, procedura e shqyrtimit të aplikimit pezullohet deri në paraqitjen e dokumentacionit ose informacionit të kërkuar.

16. Pas përfundimit të verifikimeve, struktura përgjegjëse përpilon një relacion shpjegues, në të cilin përmbledh të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe vlerësimin mbi përmbushjen ose jo të kriterëve ligjore, duke sugjeruar pranimin ose refuzimin e aplikimit. Relacioni i paraqitet për miratim Sekretarit të Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik të Regjistrin Elektronik të Ekspertëve. Në rast miratimi të aplikimit, kryhet regjistrimi i ekspertit dhe njoftimi i tij nëpërmjet portalit *e-Albania*, në adresën elektronike të deklaruar në formularin e aplikimit *online*.

17. Kërkesa për regjistrim refuzohet kur aplikanti nuk plotëson kriteret ligjore ose nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Në të dyja rastet, aplikanti njoftohet për shkaqet e refuzimit nëpërmjet portalit *e-Albania*.

18. Aplikanti, kërkesa e të cilit është refuzuar, ka të drejtë të paraqesë ankim pranë ministrit të Drejtësisë brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Ministri shqyrton ankimin dhe njofton ankuesin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e depozitimit të tij.

19. Pas shqyrtimit të ankimit, ministri i Drejtësisë vendos për pranimin ose refuzimin e tij. Në rast pranimi, procedohet me regjistrimin e aplikantit në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve dhe njoftimin e tij, ndërsa në rast refuzimi, ankuesi njoftohet për arsyet e refuzimit.

V. Pezullimi/heqja e ekspertit nga regjistri

20. Në rast se ndaj ekspertit të thirrur në gjykatë paraqiten ankesa lidhur me sjelljen deontologjike ndaj gjykatës, apo palëve në proces, ose për mospërmbushje të detyrimeve profesionale/ligjore, Ministria e Drejtësisë kryen verifikimin e tyre, duke marrë të dhëna nga gjykata përkatëse mbi procesin gjyqësor në të cilin pretendohet se eksperti nuk ka përmbushur detyrimet e tij ligjore. Ministria e Drejtësisë i kërkon ekspertit paraqitjen e shpjegimeve lidhur me faktet e konstatuara. Në rast



se konstatohet mospërmbushje e detyrimeve ligjore, Ministria e Drejtësisë procedon me çregjistrimin e ekspertit nga Regjistri Elektronik i Ekspertëve dhe njofton institucionin që ka licencuar ekspertin.

20.1. Eksperti i çregjistruar për herë të parë për shkelle deontologjike ose mospërmbushje të detyrimeve profesionale/ligjore nuk mund të regjistrohet për një periudhë 6-mujore (gjashtë-mujore) nga data e çregjistrimit.

20.2. Në rast çregjistrimi për herë të dytë për të njëjtat shkaqe, eksperti nuk mund të regjistrohet për një periudhë 1- vjeçare (njëvjeçare).

20.3. Në rast çregjistrimi për më shumë se dy herë, eksperti nuk mund të regjistrohet për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare).

20.4. Në rast çregjistrimi për më shumë se tri herë, eksperti nuk mund të regjistrohet më në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve.

21. Në rast se ndaj ekspertit vendoset një masë ndaluese në kuptim të Kodit të Procedurës Penale ose ai merret i pandehur në një proces gjyqësor, struktura përgjegjëse shënon statusin “I pezulluar” në regjistër dhe njofton ekspertin. Ky status ndryshohet ose hiqet në varësi të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në rast vdekjeje ose dënimi penal me vendim të formës së prerë, eksperti çregjistrohet nga regjistri dhe njoftohet për çregjistrimin e tij.

22. Në rast se eksperti largohet nga Shqipëria ose vendos të pezullojë ushtrimin e aktivitetit profesional, ai njofton Ministrinë e Drejtësisë dhe kërkon pezullimin e përkohshëm. Në këtë rast, në regjistër shënohet statusi “I pezulluar” dhe njoftohet eksperti për pezullimin e tij.

23. Ministria e Drejtësisë ka të drejtë:

a) të nisë procedurën e pezullimit të ekspertit, nëse vihet në dijeni të një prej fakteve të lartpërmendura në këtë udhëzim ose të një pengesë ligjore për ushtrimin e profesionit me karakter të përkohshëm;

b) të nisë procedurën e çregjistrimit, nëse vihet në dijeni të një prej fakteve të lartpërmendura në këtë udhëzim ose të mungesës së kriteve ligjore të parashikuara në pikat 4 dhe 5 të këtij udhëzimi.

Në të dyja rastet, eksperti njoftohet paraprakisht dhe ka të drejtë të paraqesë shpjegime brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

23.1. Pas shqyrtimit të të dhënave dhe parashkrimeve të ekspertit, struktura përgjegjëse i propozon Sekretarit të Përgjithshëm pezullimin ose

çregjistrimin. Vendimi i njoftohet ekspertit nëpërmjet portalit *e-Albania*.

23.2. Eksperti kundër vendimit për pezullim ose çregjistrim nga Regjistri Elektronik të Ekspertëve ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve pranë ministrit të Drejtësisë. Ministri shqyrton ankesën dhe njofton ankuesin brenda 10 (dhjetë) ditëve.

23.3. Në rast pranimit të ankimit, hiqet pezullimi ose bëhet riregjistrimi dhe eksperti njoftohet nëpërmjet portalit *e-Albania*.

VI. Procedura e korrigjimit të gabimeve

24. Pasaktësitë ose gabimet teknike, të cilat rezultojnë qartë nga dokumentacioni i depozituar dhe që nuk cenojnë vlefshmërinë e regjistrimit korrigjohen kryesisht ose me kërkesë të ekspertit.

25. Korrigjimet pasqyrohen në sistemin elektronik të Regjistrat Elektronik të Ekspertëve dhe në rast kur kërkesa për korrigjim është paraqitur nga eksperti, ai njoftohet për korrigjimin e kryer.

26. Ndryshimet e të dhënave të pasakta, të cilat nuk rezultojnë qartë nga dokumentacioni i depozituar, apo që cenojnë vlefshmërinë e regjistrimit, kryhen nëpërmjet paraqitjes së një aplikimi të ri.

VII. Procedura e përditësimit të të dhënave

27. Ministria e Drejtësisë kryen, të paktën një herë në dy vjet, verifikimin e të dhënave për çdo ekspert, me qëllim çregjistrimin e atyre që nuk plotësojnë më kushtet ligjore, ose për të cilët ekziston një pengesë ligjore për ushtrimin e profesionit.

VIII. Sistemi i pikëzimit

28. Regjistri Elektronik i Ekspertëve parashikon një sistem pikëzimi, nëpërmjet të cilit palët e interesuara vlerësojnë ekspertët për punën e kryer.

29. Sistemi i pikëzimit është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe realizohet nëpërmjet plotësimit të formularit përkatës elektronik në shërbimin “Vlerësim i ekspertëve në gjykata” në portalin *e-Albania*.

30. Ministria e Drejtësisë harton të paktën 1 (një) herë në vit një raport analize mbi të dhënat e sistemit të pikëzimit, duke evidentuar gjetjet dhe problematikat ndaj ekspertëve bazuar në pikëzimet e bëra, si dhe duke rekomanduar adresimin e tyre.

IX. Rregulla të fundit dhe tranzitore

31. Ngarkohet struktura përgjegjëse për administrimin e Regjistrat Elektronik të Ekspertëve për zbatimin e këtij udhëzimi.



32. Udhëzimi i ministrit të Drejtësisë nr. 10619, datë 19.10.2018, “Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të Regjistratit Elektronik të Ekspertëve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

33. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu

VENDIM
Nr. 10, datë 17.4.2026

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË
TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE
TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin,

transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) **Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:**

- 198 lekë/litri për gazoilin;
- 164 lekë/litri për benzinën.

b) **Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:**

- 210 lekë/litri për gazoilin;
- 176 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku është parashikuar se, në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoilin është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 17.4.2026, ora 16:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekono-



minë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega

VENDIM

Nr. 11, datë 18.4.2026

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, tran-

sportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 185 lekë/litri për gazoilin;
- 160 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 197 lekë/litri për gazoilin;
- 172 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoilin është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 18.4.2026, ora 10:30, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për



ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

